

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Për 4 muaj, 31.553 fëmijë më pak në listë, Ministria mohon dyshimet për keqpërdorime
ADRESA	https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/per-4-muaj-31553-femije-me-pak-ne-liste-ministria-mohon-dyshimet-per-keqpërdorime
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 00:55:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 17:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	189d4be3e2654e78c3022d56615848b1dc04dbf1eb8a4b7b923519a7ae9c4fb5
TEKSTI	41ebeaeb87b74c021697c4540d7d18498ad2147bd1d022bc7ae75a2033831ed7
PAMJA	dbf11b2c96d4f33cf26eab8c38ffa355b5fe78879b5e234c1061659c55f32350

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2f950ae61f134b05e397b33fec16e9490d38ceef3bbee6f695632537b1b2f9b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dda7d23b558402c926cd6fed567bb6eba8126329f8a189914308aeb661b57cd2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2f950ae61f134b05e397b33fec16e9490d38ceef3bbee6f695632537b1b2f9b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMET E MBRËMJES

Për 4 muaj, 31.553 fëmijë më pak në listë, Ministria mohon dyshimet për keqpërdorime



Foto: Arkiv
Foto: Driton Paçarada

Nga: Ilirjana Thaqi



23 shtator 2026 19:25

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Numri i fëmijëve përfitues të shtesave ka rënë për mbi 30 mijë në vetëm katër muajt e fundit. Njohës të çështjeve sociale, rënien e shohin si sinjal se mund të jenë bërë abuzime me skemën, por nga Qeveria kanë mohuar se ka parregullsi

Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare ka mohuar çdo dyshim për keqpërdorim me skemat e shtesave për fëmijë.

Ministri Andin Hoti, në një reagim në rrjetet sociale, të mërkurën, ka thënë se ulja e numrit të fëmijëve në listë nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka abuzim me skemën.

“Ua rikujtoj se shtesat për fëmijë janë realizuar pikërisht nga kjo Qeveri, prandaj është e papranueshme që, pa asnjë fakt, pa asnjë argument dhe pa i kushtuar as dy minuta leximit të legjislacionit në fuqi, të fabrikohen pretendime të paqena dhe të tentohet të ndërtohet një skandal aty ku institucionet thjesht po zbatojnë ligjin”, ka thënë ministri Hoti.

Arbëri.

Vuçiqi në Asambleenë e OKB-së falënderon shtetet që s’e kanë njohur Kosovën

Arbëri.

Vela e cilëson gjysmak vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Kulturë.

“Valle tradicionale të Opojës” në hap të ruajtjes së thesareve popullore

Showbiz.

Harvey Weinstein dënohet me 15 vjet burgim për sulm seksual

Basketboll.

Peja mposhtet thellë, kualifikimi thuajse i pamundur

Botë.

Zelensky në OKB: Putini është “pacienti zero”, prej të cilit lufta vazhdon të përhapet

ky numër që ka në të njëzëntë mijë e shtatëzet e shtatë mijë e shtatëdhjetë, siç thuhet se numri i përfituesve në kuadër të Programit të Shtesave për Fëmijë është dinamik dhe ndryshon në vazhdimësi, si rezultat i zbatimit të kriterëve të përcaktuara për këtë program dhe përditësimit të të dhënave të përfituesve.

Sipas komunikatës, në këto ndryshime ndikojnë një sërë faktorësh, duke marrë parasysh përfshirjen e fëmijëve të rinj në program, arrijten e moshës 16-vjeçare, ndryshimin e rrethanave të përfituesve, përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave me regjistrat institucionale, si dhe proceset e rregullta të verifikimit të përmbushjes së kriterëve.

Edhe



Arbëri • 8 o. më parë

Ministria për rënien e përfituesve të shtesave për fëmijë: Nuk nënkupton domosdoshmërisht keqpërdorim

Tutje theksohet se në rastet kur gjatë administrimit të programit nevojiten verifikime shtesë, pagesa mund të suspendohet deri në përfundimin e procedurave përkatëse.

“Suspendimi gjatë procesit të verifikimit nuk nënkupton automatikisht largim përfundimtar nga programi apo konstatim të keqpërdorimit. Të gjitha vendimet lidhur me vazhdimin apo ndërprerjen e përfitimit merren në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me aktet në fuqi, duke respektuar edhe të drejtat procedurale të palëve”, thuhet në njoftim.

Sipas Ministrisë, diferenca ndërmjet numrit të përfituesve në muaj të ndryshëm nuk mund të konsiderohet në tërësi si numër i personave që kanë keqpërdorur programin dhe as të përkthehet automatikisht në dëm financiar.

“Çdo rast trajtohet dhe verifikohet individualisht, ndërsa aty ku eventualisht konstatohet përfitim i pabazuar, veprohet në përputhje me legjislacionin në fuqi”, thuhet tutje në njoftim.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave, 31 mijë e 553 fëmijë më pak kanë marrë shtesa mujore në gusht krahasuar me prillin e këtij viti.

Edhe



Arbëri • 12 o. më parë

30 mijë fëmijë më pak në listat e shtesave në krahasim me prillin

Muajin e kaluar, shtesat i kanë marrë 374 mijë e 382 fëmijë.

Njohësi i çështjeve sociale, Vebi Mujku, një ditë më parë, ka paralajmëruar se zvogëlimi i numrit të fëmijëve përfitues do të vazhdojë dhe se abuzimi sipas tij, është konfirmuar në një formë nga vetë Agjencia e Statistikave.

“Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ‘konfirmon’ abuzimin me shtesa të fëmijëve në vlerë 13,5 milionë euro në vit. Ndryshimi i numrave në 31.337 përfitues të shtesave për fëmijë nga muaji prill në gusht 2026, (nga 405.722 fëmijë në 374.382 fëmijë) është një numër shumë i madh. Mesatarja e vlerës është rreth 36 euro për një fëmijë. Për një muaj ndryshimi është mbi 1 milion euro, dhe për një vit është 13.5 milionë euro. Kjo rënie do të vazhdojë edhe në muajt në vijim. Këtë dallim në numra me siguri se e përbën diaspora!”, ka shkruar Mujku.

Në korrik, nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare kanë bërë të ditur se po bëhet verifikimi i listës së shtesave.

Fëmijët aktualisht marrin nga 30 euro në muaj. Ndërsa për familjet që kanë nga tre e më shumë fëmijë, shtesa mujore për fëmijë është 45 euro.

Edhe



Arbëri • 22 qer 2026

ASK: Shtesat për fëmijë me numrin më të madh të përfituesve në maj

Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe UNICEF-it, vetëm 26.4 për qind e fëmijëve në botë janë të mbuluar nga ndonjë skemë e shtesave ose e mbrojtjes sociale.

Në Evropë, mbulueshmëria arrin në 88%, ndërsa në Afrikë e Azi Jugore, kjo shifër është nën 10 për qind.

- #SHITESAT PER FEMIJE
- #LISTAT

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 26 maj 2026

105 milionë € kostoja e shtesave, shprehet drojë se do ta rrisin inflacionin



LAJMET E MBRËMJES • 26 maj 2026

Ekzekutohen shtesat për pensionistë e fëmijë, hapet aplikimi për studentë

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS